

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurës B.A. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 820/2018, të datës 18.06.2018, të cilën e përfaqësonte Prokurori Huma Jetishi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 27.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

E pandehura B.A., nga babai E., e ëma R., e lindur F., e lindur ..., në ..., Gjermani, ku edhe jeton, ka përgatitje universitare, punon në Gjermani, ingjinierë, e ve, e gjendjes ekonomike së mesme ekonomike, gjermane, shtetase e Gjermanisë, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më date 04 Qershor 2018 rreth orës 15:50, në udhëkryqin e Rrugëve “ ... “ dhe “ ... ” në Gjiilan, e pandehura B.A., ka rrezikuar trafikun public duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “Opel Astra” me numër të regjistrimit ..., nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 61 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, për shkak të mos respektimit të rrugës me përparsi kalimi, ashtu që duke bërë kyçje të pa sigurt nga rruga dytësore në rrugën kryesore, me pjesën e përparme të automjetit “Shkoda Octavia combi” me numër të regjistrimit ... të cilën e drejtonte E.Sh.-I., e cila në atë moment ishte duke qarkulluar në rrugën me përparsi kalimi, kështu që me lëshimet e të pandehurës përveç dëmeve material në të dy veturat, lëndime të lehta trupore pëson e dëmtuara E.Sh.-I., e cila për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohet të kërkojë ndihmën mjekësore në Emërgjencën e Spitalit Regjional në Gjiilan.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarën,

E G J Y K O N

Të akuzuarës B.A., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim e akuzuara do t'a paguaj në afat prej 15 ditë nga data kur aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse e pandehura refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurën mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse e pandehura nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në contest civil.

Obligohet e akuzuara që të paguajë shpenzimet e procedurës penale edhe atë për përkthim në shumë prej 15(pesëmbëdhjetë) dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) euro, dhe paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20.00 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmarimit të dhunshëm.

Të akuzuarës i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarës në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se e njejtja ka kryer veprën penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresorë.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 27.06.2018. Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Huma Jetishi në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarën ta shpall fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit.

E dëmtuara E.Sh.-I. deklaroi, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurës ndërsa paraqes kërkesë pasurore-juridike.

E pandehura B.A., deklaroi, qe 26 vite nuk kam pasur aksident, më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhur dhe më vie shumë keq për të dëmtuarën që është lënduar dhe nuk mundë ta rikthejë situatën pasi që ka ndodhur dhe kërkojë nga gjykata që të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës nga ana e PTH në Gjilan, e pandehura B.A., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën e PTH në Gjilan dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës e cila më vihet në barrë.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit dhe të dëmtuarës, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se e pandehura B.A., duke mos respektuar rrugën me përparësi kalimi, nga pakujdesia, në kundërshtim me nenin 61 të LBSKR-së, ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, dhe nenin 61 të ligjit mbi trafikun rrugor të Kosovës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjëse penalisht.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata të pandehurën B.A., e shpalli fajtores për shkak të kryerjes së veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, dhe ka shkel dispozitat nga neni 61 të LBSKR-s, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjëse penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarës, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarës gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, ka shprehur keqardhje, i ka kërkuar falje të dëmtuarës, e dëmtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen do të ketë më tepër kujdes gjatë vozitjes dhe nuk do të kryej vepra tjera penale, kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore, dëmi material dhe lëndimi i lehtë trupor i të dëmtuarës në këtë aksident.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë, ndaj të akuzuarës B.A., është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarës, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP. Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 530/2018, Më 27.06.2018

Sekretarja juridike,

Igballe Azemi d.v

G j y q t a r i

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pëmes kësaj Gjykate.